



MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2024 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2024, Ministria e Mbrojtjes (këtu e në vijim, MM) ka përmbushur në masën 100%, detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Për 6-mujorin e parë, janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (këtu e në vijim RENjKP) dhe/ose aktiviteteve të tjera konsultative, aktet e mëposhtme:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.
3. Projektligji "Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë".
4. Projektligji "Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033".
5. Projektligji “Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.
6. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Takimet konsultative janë zhvilluar me aktorët e grupeve të interesit lidhur me projektligjin, përpos publikimit në platformën online të Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Ministria e Mbrojtjes edhe për këtë periudhë raportimi janar-qershor 2024, ka vijuar të kryejë procesin e konsultimit publik për aktet objekt i ligjit të konsultimit publik, ashtu sikundër dhe në periodat e mëparshme, duke respektuar standardet dhe parimet e procesit.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike


2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MM ka miratuar (25) akte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, nga të cilat 6 prej tyre janë të klasifikuara “Konfidencial”. Aktet e miratuara janë 17 VKM dhe 8 projektligje.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

6 (gjashtë) akte i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 19 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Grafik 1. Procesi i Konsultimit Publik



2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Janë konsultuar 3 (tre) projektligje me raport VNR, konkretisht:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.
3. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

3 (tre) prej akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45/1, shkronja a) në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, që përcakton se përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit:

a) Projektakte që trajtojnë çështje, të cilat lidhen me informacionin e klasifikuar shtetëror, çështje të sigurisë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për 22 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2024, për 3 prej tyre janë përdorur kriteret e përgjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik. Aktet e përgjashtuara nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik nuk kanë qenë të parashikuara në PKIE apo të kenë lidhje me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e konsultuara dhe të miratuara gjatë kësaj periudhe janë 6 projektligje.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me performancën institucionale të vitit të kaluar, në këtë vit vihet re një numër më i madh akteve të parashikuara të konsultuara, të cilat janë konsultuar si nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimin dhe konsultimin (RENJK), ashtu edhe nëpërmjet takimeve konsultative me grupet e interesit. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një organizim më të madh të takimeve konsultative fizikisht, të zhvilluara në të dyja fazat: si në fazën paraprake ashtu edhe në fazën e konsultimit publik, referuar lehtësimit të masave shtrënguese, por edhe mundësia e zhvillimit të takimeve nëpërmjet platformave online është një metodë tjetër që favorizon përfshirjen e një grupi më të madh të palëve të interesuara.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.2. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” ishin:

- Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 16 Janar 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
- Nëpërmjet email-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” ishin:

- Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 26 Mars 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
- Nëpërmjet email-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.
- Nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike.

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin "Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë" ishin:

- Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 9 Prill 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
- Nëpërmjet email-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.
- Nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike.

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin "Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033".

- Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 9 Prill 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
- Nëpërmjet email-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.
- Nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike.

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

- Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 20 Maj 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
- Nëpërmjet email-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.
- Nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike.

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” ishin:

- Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 13 Shtator 2023, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);

- Nëpërmjet email-it;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.
- Nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike.

2.2.3. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e cila gjeneroi më shumë komente ishte nëpërmjet zhvillimit të takimeve me anëtarët e grupeve të punës. Publikimi në regjistrin elektronik të konsultimit publik ka qenë i frytshëm sepse ka mundësuar që të interesuarit të shohin aktet, por nuk ka gjeneruar komente.

2.2.4. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, Ministria e Mbrojtjes organizoi takime paraprake për 6 (gjashtë) aktet e konsultuara, me grupet e interesit, konkretisht strukturat dhe institucionet në varësi të tij për të diskutuar të gjitha projektaktet përpara se të fillonte me hartimin e draftit të tyre.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.2. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për aktet e planifikuara gjatë vitit 2024 u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij.

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”. *Publikuar më: 16.01.2024, Mbyllur më: 13.02.2024*
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”. *Publikuar më: 26.03.2024, Mbyllur më: 23.04.2024*
3. Projektligji "Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë". *Publikuar më: 9.04.2024, Mbyllur më: 7.05.2024*
4. Projektligji "Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033". *Publikuar më: 9.04.2024, Mbyllur më: 7.05.2024*
5. Projektligji “Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”. *Publikuar më: 20.05.2024, Mbyllur më: 17.06.2024*

2.3.3. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2024, u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditë pune duke filluar nga data e publikimit.

Kurse kohëzgjatja mesatare e projektakteve të konsultuara nëpërmjet të gjitha metodave të konsultimit, duke përfshirë dhe konsultimin paraprak, ka qenë afërsisht 3 muaj.

2.3.4. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata këtë vit është përmirësuar, kjo sepse ka pasur një angazhim më të madh të rolit të koordinatorit të procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Mbrojtjes, kjo dhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në të kuptuarit më mirë të rëndësisë dhe në menaxhimin më të mirë të këtij procesi, si dhe në bashkëpunimin me efektiv me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Kryesisht, në grupet e punës për hartimin e akteve kanë marrë pjesë personeli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturat në varësi të saj. Për projektaktet që kanë impakt të drejtpërdrejtë tek grupet e interesit jashtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë organizuar takime publike.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Aktet të cilat i janë nënshtruar konsultimit publik janë diskutuar nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me strukturat në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ekspertë të jashtëm nuk ka patur.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit, numri i pjesëmarrësve në procesin e konsultimit ishte 49, ndërsa numri i pjesëmarrësve kontribues të grupeve të punës, të cilët dhanë komente dhe sugjerime me qëllim përmirësimin e projektakteve ishte 39.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Duke marrë në konsideratë natyrën e projektligjeve të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes, pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga konsultimi teknik me Ministrinë e linjës: MF, MB, SHISH, MD, MIE, DAP, MEPJ, MSHSKB, MEKI, AKP, MSHPV dhe MSHMS. Gjithashtu gjatë fazës paraprake pati sugjerime dhe kontribut edhe nga Ushtarakë pjesëmarrës në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe stafe akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të FARSH.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim më të madh të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike. Kurse të dhënat e përfituara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë 1900 vizitorë.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nga konsultimi përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, nuk ka pasur komente për aktet e publikuara dhe të konsultuara sipas kësaj metode.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Komente të mbledhura gjatë fazës së konsultimit publik, për aktet e sipërcituara e të konsultuara gjerësisht me grupet e interesit nuk ka patur.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjeneronte numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivel ndikues.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i VNR nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit pasi reagimet e mbledhura nuk ndryshojnë implikimet e politikës së krijuar.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2024, Ministria e Mbrojtjes ka publikuar 6 raporte konsultimi publik për të gjitha projektligjet e miratuara objekt konsultimi.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk kemi raporte konsultimi publik të pa publikuara. Aktualisht kemi në proces konsultimi publik 3 projektakte, për të cilat jemi në përgatitje të raporteve individuale.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Gjatë gjashtëmujorit të parë të 2024, u zhvillua procesi i konsultimit publik për 6 (gjashtë) projektaktet të cilat janë miratuar.

Sa i përket këtyre projektakteve, bëjmë me dije se është respektuar me rigorozitet procedura dhe kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”:

- projektaktet janë publikuar në RENJK;
- është dhënë informacion i mjaftueshëm;
- janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre;
- në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit;
- është respektuar afati 20 ditor.

Për këtë arsye, Ministria e Mbrojtjes është vetëvlerësuar me pikët maksimale (8) për 6 projektligjet për të cilët procesi i konsultimit publik ka përfunduar.

3 Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Procesi i konsultimit publik, pavarësisht se është një praktikë që ndiqet prej kohësh tashmë, paraqet sfida të ndryshme, që lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces.

Megjithatë, theksojmë se situata e ndërgjegjësimit sa vjen e përmirësohet, referuar edhe numrit të shikimeve të projektakteve në RENJK, duke kuptuar rëndësinë e komentimit përmes këtij regjistri, pasi është drejtpërdrejt i monitoruar nga Kryeministria duke shtuar kontrollin në reflektimin e komenteve të përcjella përmes RENJK.

Gjithashtu, krahas publikut duhet të ketë një angazhim më të madh të strukturave teknike hartuese të akteve, pasi krahas bashkëpunimit dhe dhënies së kontributit për identifikimin e grupeve të interesit të përfshira, nevojitet informimi përmes zhvillimit të trajnimeve, mbi rëndësinë e procesit të konsultimit publik të projektakteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm gjatë procesit të konsultimit, edhe me qëllim rritjen e cilësisë së performancës në këtë proces.

Me qëllim përmirësimit e cilësisë së procesit, synohet sërish ndërgjegjësimi edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacioni.